

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6232
E premte, 5 shkurt 2021
çmimi 0.40 €

Qeveria në detyrë
ndan 70 mijë euro për
shënimin e 13-vjetorit
të pavarësisë FAQE 3



INSTITUCIONET BËHEN GATI TA MBROJNË VOTËN MË 14 SHKURT FAQE 4-5

KUSH CENON VOTËN DO TË PËRBALLET ME FORCËN E LIGJIT



Prokuroria, policia dhe KQZ-ja kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor më 14 shkurt. Këto institucione kanë bërë me dije se janë pajtuar që t'i

bashkërendojnë aktivitetet me qëllim të parandalimit të keqpërdorimit të votës. Zyrtarët e këtyre institucioneve kanë dekluaruar se kushdo që cenon votën në ditën e zgjedhjeve do të përballet

me forcën e ligjit. Për mbrojtjen e votës, Prokuroria ka caktuar 88 prokurorë, Këshilli Gjyqësor 30 gjyqtarë kujdestarë, ndërsa policia ka hartuar plan operativ për ditën e zgjedhjeve

NIS GRUMBULLIMI I PLAZMËS SË GJAKUT PËR TRAJTIMIN E COVID-19 FAQE 3



Kosova ka filluar grumbullimin e plazmës konvalescente nga personat të cilët e kanë kaluar sëmundjen Covid-19, ka thënë infektologu në Klinikën Infektive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Sali Ahmeti.

Institucionet shëndetësore përmes një udhëzuesi kanë vendosur që të fillojë trajtimi i pacientëve të infektuar me koronavirus me plazmën konvalescente si terapi mbështetëse

VALBON KRASNIQI ZGJIDHET DREJTOR I SHSKUK-së FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



OPINION

AZIZ KELMENDI SHPALLET
DËSHMOR I KOMBIT DHE
EMËROHEN DISA RRUGË ME
EMRIN E TIJ F. 11

Shkruan:
Lulzim SAHITI



AKTUALE



ZEMAJ VIZITON KLINIKAT E
SHSKUK-SË, THOTË SE NDIHET
KRENAR ME MANTELbardhët F. 10

RREGULLOHET URA NË HAJNOC
TË KAMENICËS F. 10



REALIZOHEN 83 PËR QIND E
PAGESAVE TË PLANIFIKUARA TË
BUXHETIT PËR VITIN 2020 F. 9

SHTYHET SËRISH ORGANIZIMI I
FORUMIT EKONOMIK BOTËROR F. 9

SPORT

PHILADELPHIA MPOSHTI
CHARLOTTEN, SHKËLQEN
ANTETOKOUNMPOS F. 12

RENOVA
PUTZ
Makedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curë-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVO
Ruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Administratës Biden i bëhet thirrje ta shtyjë afatin për tërheqje të trupave nga Afganistani

UASHINGTON, 4 SHKURT - Një raport i ri, i krijuar nga Kongresi, i ka bërë thirrje administratës së presidentit amerikan, Joe Biden, që të mos ketë majin si afat të fundit për tërheqje të trupave të mabetura ushtarake në Afganistan. Në raportin e publikuar më 3 shkurt, Grupi për Studim të Afganistanit ka rekonduar mbajtjen e trupave amerikane në këtë shtet, "në mënyrë që t'i japë procesit kohë të mjaftueshme për të prodhuar rezultat të pranueshëm". Grupi për Studim të Afganistanit është panel që funksionon në kuadër të Institutit të Paqes në Shtetet e Bashkuara. Në raport paneli ka

thënë se Shtetet e Bashkuara kanë interes të madh që Afganistani të mos "kthehet sërisht në strehë të sigurt për terroristët".

Sipas marrëveshjes së shkurtit të vitit të kaluar, të nënshkruar nga Shtetet e Bashkura bashkë me talibanët, Uashingtoni është zotuar për të reduktuar në zero numrin e trupave që ka në Afganistan deri në maj të vitit 2021.

Ish-presidenti amerikan, Donald Trump, që ka bërë fushatë më 2016 për t'iu dhënë fund "luftërave qesharake dhe pafund", në Lindje të Mesme, pati tentuar ta shpejtonte procesin e zvogëlimit të trupave në muajin nëntor.



Pentagoni ka thënë më 28 janar se tërheqja e trupave amerikane në Afganistan do të jetë në përpunhje me përkushtimet e bëra nga

talibanët për ta zbatuar marrëveshjen e arritur më 2020.

"Talibanët nuk kanë jetësuar përkushtimet e tyre", ka thënë

sekretari për media i Pentagonit, John Kirby. Ai ka shtuar se sekretari amerikan i Mbrojtjes, Lloyd Austin, është duke rishikuar këtë çështje dhe ka diskutuar për të ardhmen në këtë shtet bashkë me aleatët e NATO-s.

Në raportin e publikuar më 3 shkurt, paneli ka bërë thirrje edhe për mbështetje amerikane në institucionet afgane, duke përfshirë institucionet e sigurisë, "ndërkoqë që vazhdon të ekzistojë mesazhi ndaj partnerëve afganë se mbështetja amerikane nuk është e pafundme dhe se varet nga përparimi që bëhet në bisedimet për paqe".

Policia kineze shkatërron grupin që shiste vaksina të rreme për Covid-19

PEKIN, 4 SHKURT - Policia kineze ka arrestuar më shumë se 80 persona të dyshuar të një grupi kriminal, i cili ka prodhuar dhe shitur vaksina të rreme kundër koronavirusit, në dhe jashtë Kinës. Zyrtarët politorë në Pekin dhe në provincat Jiangsu dhe Shandong, kanë nisur operacionet pasi ka pasur dyshime se janë duke u prodhuar vaksine të rreme me përbërje të thjeshtë kripore, ka raportuar agjencia e lajmeve "Xinhua". Vaksinat janë shitura në Kinë dhe në shtetet tjera, ndonëse ende nuk janë bërë të

ditur emrat e vendeve tjera. Sipas medies shtetërore, ky grup ka qenë aktiv prej shtatorit të vitit të kaluar. "Kina tashmë ka raportuar për këtë situatë te vendet tjera relevante. Qeveria kineze vlerëson lart sigurinë e vaksinës dhe do të vazhdojë të bëjë përpjekje për të ndjekur penalish se cilin falsifikim, shitje të rreme dhe biznese joligjore. Në të njëjtën kohë, Kina do të forcojë bashkëpunimin me shtetet relevante për të parandaluar përhapjen e këtyre veprimeve joligjore dhe kriminale", ka

thënë zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme kineze, Wang Wenbin. Kina ka një histori të gjatë të skandaleve me vaksina, duke nisur nga problemet me prodhim e deri te praktikat biznesore.

Më 2016, policia ka arrestuar dy persona, të cilët kanë qenë të angazhuar në një rrjet të shitjes së miliona vaksinave të ruajtura në mënyrë joadekuate në gjithë territorin kinez. Si përgjigje ndaj kësaj, Kina ka reformuar rregulloret përsiguri të vaksinave dhe ka rritur gjobat për ata që kryejnë shkelje.



Si pasojë e të nxehtit, Australia përfshihet nga zjarret

Perth, 4 shkurt - Shumë skuadra zjarrfikësish kanë dalë në terren të shuar zjarret pyjore në Australi që kanë përvshirë rrethinat e qytetit të Perth, të izoluar nga koronavirusi. Zjarret përvëluese kanë shkatërruar deri tanë 70 shtëpi,

duke detyruar evakuimin e shumë familjeve. Kufizimet e Covid-19 janë vendosur për të gjithë Australinë perëndimore përvetëm një rast infektimi të zbuluar, por zyrtarët tashmë thonë se në rend të parë duhet të vendoset evakuimi. Më

shumë se 300 punonjës emergjencash po përpilen të kufizojnë flakët dhe helikopterë po lëshojnë ujë mbi zonat pyjore që po digjen. Moti i nxehët dhe i thatë i ditëve të fundit ka ndihmuar në përhapjen e zjarreve.



ShBA-ja dënon raportimet për dhunim të ujgurëve në Kinë



UASHINGTON, 4 SHKURT - Shtetet e Bashkuara "janë të shqetësuara thellë" nga raportimet për dhunime sistematike dhe abuzime seksuale të grave në kampet e përqendrimit për ujgurët etnikë dhe myslimanët tjerë në rajonin Ksinqiang të Kinës, ka thënë Departamenti amerikan

i Shtetit më 3 shkurt. "Këto mizori janë tronditëse për ndërgjegjen dhe duhet të përballen me pasoja", ka thënë një zëdhënës i Departamentit të Shtetit përmes postës elektronike për Radion Evropa e Lirë.

Këto komente vijnë pas raportimit të BBC-së një ditë

më parë, në të cilin është cituar një grua që ka ikur nga Ksinqiang. Ajo ka përmendur gjatë rrëfimit të saj, dhunë, torturë dhe rrabje nëpër kampe. Departamenti amerikan i Shtetit ka përsëritur akuzat se Kina është duke kryer "krime kundër njerëzimit dhe gjenocid" në Ksinqiang.

Nis grumbullimi i plazmës së gjakut për trajtimin e Covid-19

PRISHTINË, 4 SHKURT - Kosova ka filluar grumbullimin e plazmës konvalescente nga personat të cilët e kanë kaluar sëmundjen Covid-19, thotë për "Radion Evropa e Lirë" infektologu në Klinikën Infektive në Qendrën Klinikë Universitare të Kosovës, Sali Ahmeti.

Institucionet shëndetësore përmes një udhëzuesi kanë vendosur që të fillojë trajtimi i pacientëve të infektuar me koronavirus me plazmën konvalescente, si terapi mbështetëse.

Infektologu Ahmeti, i cili njëherësh është kryesues i grupit punues për hartimin e protokollit për përdorimin e plazmës konvalescente, thotë se kanë përfunduar të gjitha procedurat administrative për fillimin e dhënes së plazmës konvalescente.


"Transfuzioni i gjakut ka filluar grumbullimin e dozave të para. Me udhëzuesin tonë këtë trajtim me plazmë konvalescente do ta aplikojmë te format e rënda të sëmundjes ose te format që kanë tendencë të përkeqësimit të shpejtë", thotë Ahmeti.

Sa i përket sasisë së grumbulluar të plazmës konvalescente, Bukturje Zhubi, drejtoreshë e Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzion të Gjakut

(QKKTGJ), ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë" se deri më tani kanë pasur vetëm tre dhurues të plazmës. "Shpresojmë që në ditët në vijim të kemi më shumë doza të plazmës", tha shkurt Zhubi. Trajtimi i pacientëve me Covid-19 me plazmë konvalescente bëhet duke marrë plazmën e gjakut nga pacientët e shëruar nga koronavirusi, pasi që gjaku i tyre ka antitrupa që luftojnë virusin. Transfuzioni i antitrupave besohet se krijon atë që njihet si "imuniteti pasiv" te të prekurit me Covid-19.

Infektologu Ahmeti tha se trajtimi i pacientëve me Covid-19 me plazmë konvalescente mund të rezultojë me efekte të mira te pacientët që e marrin këtë trajtim në kohën e duhur. "Do t'i bëjmë përvojat tonë të para, por duke iu referuar përvojave të tjera disa nxjerrin efekte të mira e disa efekte më të pakta. Sa më shpejt që jepet plazma, pritshmëria përfikasitetin e saj është më e madhe, pasi që kjo përban antitrupa që e bëjnë neutralizimin e virusit në depërtimin e tij në receptorët e qelizave gjegjëse", theksón Ahmeti.

Ndarja e gjakut nga plazma bëhet në Qendrën Kombëtare



të Kosovës për Transfuzion të Gjakut. Kjo metodë e trajtimit përmes plazmës është aplikuar në vazhdimësi për shumë sëmundje brenda Klinikës Infektive të QKUK-së. Në janar të këtij viti Komisioni Evropian njoftoi se do të mbështesë një sërë projektesh për trajtimin e koronavirusit me plazmën konvalescente. Trajtimi përfshin transfuzionin e plazmës konvalescente te pacientët e sëmurë, në mënyrë që t'ua përmirësojë imunitetin dhe aftësinë e tij për ta luftuar

virusin. Po ashtu, kjo formë e trajtimit do të mund t'i ofronte industrisë së shëndetësisë që t'i pastrojë antitrupat dhe të bëjë një produkt shëndetësor për Covid-19 (imunoglobulinë). "Përfikasitetin e këtyre dy qasjeve po kryhen hetime në mbarë botën, përfshirë edhe projektet që BE-ja financon. Këto dy lloje të trajtimeve mbështeten në grumbullimin e sasisë të mëdha të plazmës konvalescente nga pacientët e shëruar nga Covid-19", ka njoftuar Komisioni Evropian.

Sipas këtij institucioni të BE-së, rezultatet e para janë premtuese, me pak të dhëna që tregojnë përrastë kur ka pasur efekt të kundërt. Rezultatet e tjera priten të dalin pas provave klinike. "Rezultatet e deritashme sugjerojnë se transfuzioni më i hershëm (i plazmës së gjakut) nga donatorët, përbajnjë më shumë antitrupa dhe ofrojnë më shumë efikasitet përluljen e vdekshmërisë te pacientët me koronavirus", ka njoftuar BE-ja.

Qeveria në detyrë ndan 70 mijë euro për shënimin e 13-vjetorit të pavarësisë



PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj mbajtur të enjten, ka miratuar vendimin për themelin e Këshillit organizativ për shënimin e trembhjetëvjetorit të shpaljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Përpunën e këshillit organizativ për shënimin e 13-vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, qeveria ka ndarë mjete financiare në vlerë prej 70 000 eurosh. "Këshilli organizativ për shënimin e 13-vjetorit të pavarësisë do të ketë këtë përbërje: 1. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryesuese; 2.

Përfaqësues, Ministria e Mbrojtjes, anëtar; 3. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtar; 4. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar dhe 5. Përfaqësues i Zyrës së Kryeministrit, anëtar", është thënë në njoftimin e qeverisë, duke ftuar që të dërgojnë nga një përfaqësues në këtë këshill edhe zyra e presidentit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Komuna e Prishtinës, kryetarët e organizatave të dala nga lufta e UÇK-së, kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe përfaqësues të OJQ-ve.

Emiratet e Bashkuara Arabe, të përkushtuara për bashkëpunim me Kosovën

PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka pritur të enjten në takim ambasadoren jorezidente të Emirateve të Bashkuara Arabe në Kosovë, Nabila Abdelaziz Alshamsi.

Hoti e falënderoi ambasadoren Alshamsi për ndihmën e vazdueshme që

Emiratet e Bashkuara Arabe i kanë ofruar Republikës së Kosovës në të gjitha etapat e shtetndërtimit. Kryeministri Hoti shprehu përkushtimin dhe gatishmërinë e qeverisë për thellimin e bashkëpunimit në çdo fushë me interes të ndërsjellë, në veçanti për thellimin e marrëdhënieve

ekonomike dhe përpromovimin e investimeve nga Emiratet e Bashkuara Arabe në Republikën e Kosovës. Kryeministri Hoti dhe ambasadorja Alshamsi u pajtuan se Kosova ka shumë potential përvillim që duhet mbështetur e promovuar.





INSTITUCIONET BËHEN GATI PËR TA MBROJTUR VOTËN MË 14 SHKURT

Kush cenon votën do të përballet me forcën e ligjit

Prokuroria, policia dhe KQZ-ja kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor më 14 shkurt. Këto institucione kanë bërë me dije se janë pajtuar që t'i bashkërendojnë aktivitetet me qëllim të parandalimit të keqpërdorimit të votës. Zyrtarët e këtyre institucioneve kanë deklaruar se kushdo që cenon votën ditën e zgjedhjeve do të përballet me forcën e ligjit. Për mbrojtjen e votës, Prokuroria ka caktuar 88 prokurorë, Këshilli Gjyqësor 30 gjyqtarë kujdestarë, ndërsa policia ka hartuar plan operativ për ditën e zgjedhjeve

EPOKA ERE **Muhamed KOCI**

PRISHTINË, 4 SHKURT - Institucionet kompetente kanë marrë të gjithë masat për ta mbrojtur votën më 14 shkurt. Prokuroria dhe policia kanë bërë me dije se do të sigurojnë integritet të procesit zgjedhor dhe nuk do të lejojnë keqpërdorimin e asnjë vote. Ndërsa Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vlerësuar se vetëm bashkëpunimi ndërinstitucional është i domosdoshëm për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor. Për ta mbrojtur votën prokuroria ka caktuar 88 prokurorë dhe 40 zyrtarë në mbrojtjen e votës së qytetarëve në ditën e zgjedhjeve, kurse Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka njoftuar se ka angazhuar 30 gjyqtarë kujdestarë që do t'u përgjigjen kërkesave të prokurorisë. Në këtë proces janë përfshirë

edhe ekspertët amerikanë për shkëmbim të përvojave në mbrojtjen e votës. Me iniciativë të Ambasadës Amerikane në Prishtinë, përmes platformave virtuale, është realizuar punëtori dyditore me ekspertë amerikanë të Departamentit të Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara lidhur me luftimin e kimeve zgjedhore. Në këtë punëtori kanë marrë pjesë mbi tetëdhjetë e tetë (88) prokurorë të shtetit të Republikës së Kosovës, që do të janë të angazhuar në zgjedhjet e 14 shkurtit për të trajtuar çfarëdo veprimi eventual që bie ndesh me ligjin penal. Gjatë kësaj punëtorie ekspertët amerikanë dhe prokurorët e shtetit kanë shkëmbyer përvojat e tyre lidhur me rolin e prokurorëve të shtetit për mbrojtjen e votës. Gjithashtu, gjatë kësaj punëtorie janë diskutuar edhe parimet e përbashkëta lidhur me procesin e mbrojtjes së votës për zgjedhjet parlamentare të

14 shkurtit. Koordinatorja nationale e zgjedhjeve në zyrën e Prokurorit të Shtetit, Laura Pula, ka deklaruar se ditën e zgjedhjeve prokurorët do të janë në krye të detyrës. Ajo ka ftuar të gjithë qytetarët që të mos cenojnë votën, duke shluar se kush bën një gjë të tillë do të ballafaqohet me forcën e ligjit. "Dua t' dal me një mesazh që prokurori së bashku me policinë do t'i arrestojnë apo ndalojnë t'i gjithë zyrtarët që në çfarëdo mënyre ndikojnë në keqpërdorimin e votës së qytetarit të Kosovës", ka thënë Pula për mediet. Ajo ka deklaruar se prokuroria është e gatshme ta arrestojë selenin që cenon votën në ditën e zgjedhjeve. Kurse kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, ka vlerësuar se bashkëpunimi ndërinstitucional është i domosdoshëm për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor. "Dua t'i garantoj të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces zgjedhor, sidomos qytetarët tanë, se KQZ-ja mbetet e përkushtuar për organizimin e zgjedhjeve sipas Kushtetutës, ligueve në fuqi dhe me standartet më të mira ndërkombëtare", ka deklaruar Daka. Edhe Policia e Kosovës ka hartuar një plan operativ për zgjedhjet e 14 shkurtit. Përmes njoftimit për media, Policia e Kosovës ka bërë me dije se përmes hartimit të urdhrit operativ policor ka bërë të gjitha planifikimet lidhur me zgjedhjet e parakohshme parlamentare të cilat do të

mbahen më 14 shkurt. Policia ka njoftuar se me qëllim të ofrimit të sigurisë dhe mbarëvajtjes së procesit zgjedhor janë bashkërenduar aktivitetet me Prokurorinë e Shtetit dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve përderisa në aspektin policor do të angazhohen një numër i mjafueshëm i zyrtarëve policorë të profileve të ndryshme që iu përkasin njësive të ndryshme brenda Policisë së Kosovës. "Planifikimi operativ ka paraparë implementimin dhe realizimin e planit policor në katër fazë, duke filluar nga: 1) Periudha parazgjedhore apo përgatitore vlerësuese; 2) Angazhimi për ofrimin e sigurisë gjatë fushatës zgjedhore; 3) Garantimi i sigurisë në fazën kyçë të ditës së zgjedhjeve dita (Z); 4) Periudha pas zgjedhjeve që parashev transportin nën përcjellje dhe siguri të PK-së, të materialit sensitiv e deri në përfundim të procesit", është Pula për mediet. Policia e Kosovës ka bërë me dije se ka marrë masa shtesë duke caktuar edhe koordinatorë të Policisë me KQZ-në dhe institucionet e tjera të angazhuara në këtë proces, si dhe hartimin e një udhëzuesi për zyrtarët policorë lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre ligjore gjatë procesit zgjedhor.

"Voto për Kuvendin e Kosovës", slogan i KQZ-së për zgjedhjet e 14 shkurtit

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në mbledhjen e mbajtur të enjten ka miratuar sloganin për zgjedhjet e parakohshme parlamentare që do të mbahen më 14 shkurt 2021. "Voto për Kuvendin e Kosovës" do të jetë slogan i KQZ-së për këto zgjedhje. Ndërsa dizajni i kësaj logoje pritet të ndryshohet pas disa kërkesave që patën anëtarët e KQZ-së e për të cilat u pajtuan të gjithë. Anëtarët e KQZ-së u pajtuan edhe për dizajnin e fletëvotimit.

Marrëveshje bashkëpunimi në mes të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës



PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Në mjetin e Ministrisë së Mbrojtjes të enjten u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Marrëveshja u nënshkrua nga Rozafa Ukimeraj, sekretare e

përgjithshme e MM-së dhe Avni Ahmeti, drejtor ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Në aktin e nënshkrimit ishte i pranishëm edhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama.

Marrëveshja e bashkëpunimit

në mes të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës ka për qëllim zhvillimin e dy institucioneve përkatëse në fushën e hartografisë dhe gjenealogjive, obligimet e marrëveshjeje, obligimet e përbashkëta të dy institucioneve do të realizohen në

mënyrë reciproke përmes trajnimeve profesionale dhe vizitave studentore me qëllim të ngritjes së kapaciteteve menaxhuese të MM-së dhe AKK-së. Sipas kësaj marrëveshjeje, obligimet e përbashkëta të dy institucioneve do të janë:

angazhimi për krijimin e projekteve afatshkurtër dhe afatmesme në aspektin e hartografisë dhe gjeoinformacionit si dhe ofrimi i hapësirave për krijimin e kushteve optimale për realizimin e aktiviteteve të bashkëpunimit.

Valbon Krasniqi zgjidhet drejtor i ShSKUK-së



PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Valbon Krasniqi është zgjedhur në pozitën e drejtorit të Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës është bërë me dije përmes një njoftimi nga ShSKUK, ku janë publikuar edhe rezultatet finale të

konkursit. "Komisioni vlerësues për përzgjedjen e drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK), bazuar në Ligjin 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe legislacionin tjetër në fuqi, ka shpallur rezultatet e

konkursit për pozitën e drejtorit të përgjithshëm të ShSKUK-së. Procesi ka qenë transparent dhe në të kanë marrë pjesë përfaqësuesi nga shoqëria civile, Shoqata për të Drejtat e Pacientëve, përfaqësuesi i Federatës Sindikale i

Shëndetësisë", thuhet në njoftim.

Në fazën e fundit të këtij konkursi gara u bë në mes të Krasniqit dhe Basri Lenjanit, pasi tre kandidatë të tjera ishin larguar nga gara me akuza për parregullsi në këtë konkurs.

Krasniqi është vlerësuar me 34 pikë në test, 8 në CV si dhe 49.2 në intervistë, ndërsa Lenjani mori 19 pikë në test, 10 në vlerësimin e CV-së dhe 46.6 në intervistë. Lidhur me këto rezultate, kandidatët kanë të drejtë ankese brenda 15 ditëve.

Pesë të vdekur dhe 318 raste të reja me Covid në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 SHKURT - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 2 303 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilave kanë rezultuar 318 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar pesë raste të vdekjes si pasojë e këtij virusi. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Gjakovë një rast (80

vjeç), Kamenicë një rast (65 vjeç), Kaçanik një rast (72 vjeç), Prizren një rast (72 vjeç) dhe Vushtrri një rast (80 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 61 404 raste nga 242 999 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 514 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 214 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 53 231 raste, kurse numri i rasteve aktive është 6 659.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 121 raste, Prizren 38 raste, Gjakovë 23 raste, Pejë 17 raste, Suharekë 16 raste, Gjilan 11 raste, Mitrovicë 11 raste, Ferizaj 10 raste, Podujevë 10 raste, Fushë-



Kosovë 9 raste, Deçan 8 raste, Istog 3 raste, Kamenicë 3 raste, Rahovec 8 raste, Vushtrri 8 raste, Drenas 2 raste, Kaçanik 2 raste, Lipjan 6 raste, Obiliq 4 raste, Viti 2 raste dhe me nga 1 rast komunat Dragash dhe Malishevë.

Zemaj viziton klinikat e ShSKUK-së, thotë se ndihet krenar me mantelbardhët

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 SHKURT - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka vizituar të enjten klinikat e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK).

Zemaj të enjten është takuar me specializantët që para pak kohe kanë filluar arsimimin specialistik. "Jam tepër krenar sepse kemi arritur të japim specializime sipas numrit dhe cilësisë, si asnjëherë deri më sot në historinë e ShSKUK-së. Në Klinikën e ORL-së janë regjistruar 42 specializantë, në Gjinekologji dhe Obstetrikë 51 specializantë, Pulmologji 39 specializantë, në Mjekësi Emergjente 38, si dhe Anesteziologji me Mjekim Intensiv 44 specializantë. Këta specializantë do t'u shtohen radhëve të armatës së profesionistëve shëndetësorë kundër Covid-19, duke e ngritur përqindjen e mjekëve për numër të banorëve, me kushte të mira për të qëndruar në Kosovë, të aftësuar me dijet



superiore në fusha të ndryshme, duke u vënë në shërbim të shëndetit të qytatarëve tanë", ka thënë

Zemaj. Ai ka theksuar se Kosova është e bekuar me mjekët e saj që me ndershmëri dhe profesionalizëm kujdesen

për mirëqenien shëndetësore. Ministri Zemaj ka vizituar edhe Qendrën Klinike Stomatologjike Universitare të

Kosovës, ku me drejtuesit e kësaj klinike ka diskutuar përkushtet, decentralizimin e përkujdesjes stomatologjike, në veçanti për kuadrin e ri dhe specializimet e reja. "QSKUK-ja edhe në kohë pandemie ka ofruar shërbime në pajtim me detyrat dhe obligimet ligjore, duke u bërë shembull për ofrimin e përkujdesjes stomatologjike e nivelit tertiar. Në QSKUK janë dhënë specializime si asnjëherë më parë, duke u ofruar mjekëve të rinj, gjasa e mundësi përspecializim. Duhet theksuar se në Kirurgjinë Orale janë 83 specializantë të rinj, Paradontologji dhe Mjekësi Orale 37 specializantë të rinj, në Pedodonci 14, Sëmundje të Dhëmbit me Endodonci 29, në Ortodonci 86 dhe në Protetike Stomatologjike 53 specializantë të rinj. E përgjëzova stafin drejtues të QSKUK-së, kuadrin profesional dhe kuadrin e ri të angazhuar brenda kësaj Qendre, duke cekur se vërtet ndihem krenar me ta", ka deklaruar Zemaj pas kësaj vizite.

Edhe në Kosovë shënohet Dita Botërore Kundër Kancerit

PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Në Klinikën e Onkologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës është shënuar Dita Botërore Kundër Kancerit. Me këtë rast, dr. Vildane Goga, onkologe, ka thënë se Klinika e Onkologjisë ka 55 shtretër përmjekim ambulantor si dhe 15 shtretër përmjekim spitalor. Ndërsa ka shtuar se në këtë klinikë ka rrëth 230 vizita ditore të patientëve.

Dr. Goga ka shpjeguar se gjatë vitit 2020 janë trajtuar 1 336 raste të reja të diagnostikuara me kancer. Ish-presidentja e vendit, Atifete Jahjaga, ka thënë se Kosova ka profesionistë të dëshmuar të cilët pa u kursyer janë gjendur gjithmonë afér patientëve. Ndërsa tjetra, Jahjaga ka shprehur falënderim stafit të Klinikës së Onkologjisë, përpunën dhe përkushtimin e

treguar brenda këtij viti sfidues të ballafaqimit me Covid-19. Kryetar i Shoqatës së Onkologëve të Kosovës, Arben Bislimi, ka thënë se në botë 10 milionë persona vdesin në vit si pasojë e kësaj sëmundjeje. Dr. Bislimi u shpreh se arsyja që jemi këtu është Dita Botërore Kundër Kancerit, duke theksuar se çdo vit jemi në aktivitete sensibilizuese.



Aktivitete të partive politike në kuadër të fushatës së zgjedhjeve të 14 shkurtit

Hoxhaj: Skenderaj dhe Vushtria kanë vendosur për PDK-në


SKENDERAJ, 4 SHKURT - Kandidati për kryeministër nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, ka thënë se Skenderaj dhe Vushtria janë të vendosur për ta mbështetur programin e kësaj partie për zgjedhjet e 14 shkurtit. "Skenderaj dhe Vushtria janë të vendosur për rimëkëmbje. Këtë më së miri e dëshmojnë takimet dhe masa e mbështetësve tanë në këto dy qytete", ka thënë Hoxhaj, duke shtuar se nuk ka forcë që e ndalon Drenicën dhe PDK-në. "Nuk do të ketë forcë që e ndalon as vizionin e Hashim Thaçit e Kadri Veselit për shtetin e Kosovës. Duke qëndruar të bashkuar në Drenicë dhe anekënd Kosovës u japim përgjigjen më të mirë atyre që po përpinqen ta njollosin UÇK-në dhe themeluesit e saj. Ne jemi partia e çlirimt, pavarësisë dhe shtetndërtimit. Ne do të jemi edhe partia e zhvillimit ekonomik dhe integrimit euroatlantik", është shprehur ai. Në takimin me qytetarët e Vushtrisë, Hoxhaj ka thënë se edhe Vushtria është rreshtuar me PDK-në.



Kurti: Duhet të kemi më shumë se 60 deputetë

Prishtinë, 4 shkurt - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kandidat për kryeministër, Albin Kurti, së bashku me Vjosa Osmanin, para pjesëmarrësve në veturat e parkuara te 'Pallati i

zhvillimit të saj. "Grupi tjetër me të cilin konfrontohemi për mbrojtjen e shtetit të Kosovës, në vitet '90 bënte thirrje që të marrim pjesë në zgjedhjet e Serbisë. Kjo është e vërtetë. E ka kundërshtuar marrëveshjen e Rambujesë, e ka kundërshtuar Planin e Ahtisarit, janë vranë njerëzit në rrugë në vitin 2007 duke e kundërshtuar këtë plan. Vetëm shihni listën e tyre, të mbushur me ekstremistë të të gjitha formave, duke përfshirë edhe adhurimtarë të Enver Hoxhës", ka thënë Hoti. Ai ka shtuar se qeverisja e LDK-së për shtatë muaj ka arritur rezultate historike për Kosovën, duke theksuar se vota për numrin 132 më 14 shkurt është votë për projektin e shtetit të Kosovës.



Hoti: LDK-ja e vendosur për mbrojtjen e shtetit

Klinë, 4 shkurt - Kandidati i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryeministër, Avdullah Hoti, ka thënë të enjten, gjatë tubimit elektoral në Klinë, se fitorja e LDK-së më 14 shkurt është fitore e Kosovës dhe

Rinisë, dhe mijëra qytetarëve që po e ndiqnin ngjarjen nga shtëpitë e rrjetet sociale, hapën të mërkurën në mbërëmje zyrtarisht fushatën për zgjedhjet e 14 shkurtit. Ai ka bërë thirrje që sa më shumë qytetarë të dalin të votojnë. "Sondazhet janë duke e treguar se për çdo 10 persona, gjashtë prej tyre janë votues të LV-së. Këto sondazhe më ngjallin një frikë se

Kurti. Lëvizja Vetëvendosje të enjten ka mbajtur takim edhe me qytetarët e Kaçanikut.

Limaj: Kauza jonë 'me çlirimtarët' po jehon fuqishëm kudo në Kosovë

MALISHEVË, 4 SHKURT - Lideri i Nismës Socialdemokrate,

Fatmir Limaj, në kuadër të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 14 shkurtit, ka takuar banorët e disa fshatrave të Malishevës. Limaj në këto takime, ka thënë se kauza e tyre "Me Çlirimtarët" për mbrojtjen e vlerave kombëtare, është duke jehuar fuqishëm në Llapushë dhe kudo nëpër Kosovë. "Pritja madhështore që iu bë mbrëmë çlirimtarëve të

numrin 121, numrin e listës së çlirimtarëve, numrin e fitoreve", ka shkruar Limaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Haradinaj thotë se vota për president është referendum për një atdhe të sigurt

Vushtri, 4 shkurt - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, të enjten ka takuar qytetarët e Skenderajt dhe të Vushtrisë. Ai ka thënë se është për tu krenuar me strukturat e partisë në këtë qytet, në kohët kur vendi ynë ka nevojë më shumë se kurrë për energji të tilla që tregojnë vendosmëri në rrugë tonë drejt fuqizimit të shtetit dhe së ardhmes tonë. "Vota për president është referendum për një atdhe të sigurt dhe të integruar në struktura euro-atlantike dhe është obligim për mua që të qëndroj i palëkundur për të ardhmen e Kosovës ashtu siç e duam të gjithë", është shprehur Haradinaj. Ndërkohë në Vushtri kryetari i AAK-së ka thënë se partia që drejton është adresë e mbrojtjes së interesave kombëtare, balancimit të pushtetive, rrugëtimit drejt NATO-s, apo referendumit për bashkim me Shqipërinë.



Realizohen 83 për qind e pagesave të planifikuara të buxhetit për vitin 2020



Qeveria në detyrë e Kosovës ka mbajtur të enjten mbledhjen e 61-të në të cilën është konfirmuar se janë realizuar 83 për qind e pagesave të planifikuara të buxhetit për vitin 2020. Po në këtë mbledhje është emëruar anëtar i bordit i përkohshëm në KEK si dhe janë ndarë 12 milionë euro për Ministrinë e Bujqësisë për subvencione dhe transferim

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 SHKURT - Qeveria në detyrë e Kosovës ka mbajtur të enjten mbledhjen e 61-të në të cilën ka njoftuar se gjatë viti 2020 janë realizuar 83 për qind e pagesave të planifikuara të buxhetit. Sipas njoftimit të qeverisë, krahasuar me vitin e kaluar, pagesat janë rritur për 8 për qind. "Pas shqyrtimit është aprovuar raporti preliminar financiar për ekzekutimin e

buxhetit dhe bilancin e fondevë për vitin 2020. Sipas rapportit, pranimet gjatë vitit 2020 kapin shumën prej 2 miliardë e 204 milionë e 680 mijë eurosh, që janë 85 për qind të pranimeve vjetore të planifikuara dhe në krahasim me vitin paraprak, ka një ulje prej 1-përqindësh. Ndërsa pagesat gjatë këtij viti kanë qenë 2 miliardë e 329 milionë e 87 mijë euro dhe paraqesin 83 për qind të pagesave të planifikuara, ndërsa në krahasim me vitin paraprak

shënojnë një rritje prej 8-përqindësh", theksohet në njoftimin e qeverisë. Po në këtë mbledhje janë miratuar vendime dhe dokumente nga fushat e përgjegjësive kushtetuese dhe ligjore të qeverisë. "Me vendimin e miratuar në mbledhjen e sotme është ndryshuar dhe plotësuar edhe vendimi i qeverisë nr. 01/37, i datës 24.10.2020, për emërimin e bordit të përkohshëm të N. P. 'Korporata Elektroenergetike e

Kosovës - KEK' Sh. A. Sipas këtij ndryshimi dhe plotësimi, Muhamet Lama është emëruar anëtar në bordin e përkohshëm të drejtoreve në këtë ndërmarrje publike, deri në përzgjedhjen e bordit me mandat të plotë", është thënë në njoftimin për media.

Qeveria ka ndarë edhe 12 milionë euro për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Kryeministri në detyrë, Avdullah Hoti, ka treguar se kjo shumë është ndarë për subvencione dhe transferime. "Në takimin online qeveria në detyrë ka marrë një sërë vendimesh, midis tyre: 10 mijë euro janë ndarë për rindërtimin e Kalasë së Ulqinit, pas dëmeve të shkaktuara nga vërvshimet në Mal të Zi. Me 200 mijë euro do të ndihmohet Komuna e Bujanocit për

sanimin e dëmeve nga vërvshimet. Qeveria ka ndarë 12 milionë euro për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për subvencione dhe transferime. Qeveria ka autorizuar Klinikën e Ortopedisë në ShSKUK që në koordinim me MPMS-në dhe me Shoqatën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, ta bëjë furnizimin dhe rregullimin e protezave dhe ofrimin e shërbimeve të tjera për nevoja të invalidëve të luftës së UÇK-së. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtyre shërbimeve do të mbulohen nga buxheti i Republikës së Kosovës, në pajtim me legjislacionin në fuqi", ka thënë Hoti, duke theksuar se qeveria në detyrë vazhdon të kryejë me përkushtim detyrat që burojnë nga mandati i saj.

Bien për 30 për qind shitjet e makinave në Gjermani



BERLIN, 4 SHKURT - Regjistrimet e reja të makinave të pasagjerëve në Gjermani ranë me 170 mijë apo më shumë se 30 për qind. Përfaqësitet e makinave janë goditur nga një bllokim

i dytë mes pandemisë Covid-19 në Gjermani, me dyqanet jo thelbësore të mbyllura që nga mesi i dhjetorit 2020 dhe nga lehtësimet e taksave për konsumatorët që mbarojnë në fund të vitit

2020. Regjistrimet e makinave të reja në dhjetor 2020 ishin rritur gati 10 për qind. Autoriteti i makinave KBA pritet t'i publikojë shifrat zyrtare të shitjeve.

Shtyhet sërisht organizimi i Forumit Ekonomik Botëror

DAVOS, 4 SHKURT - Organizimi i Forumit Ekonomik Botëror është shtyrë sërisht nga maji përmuanj gusht të këtij viti për shkak të atyre që janë konsideruar "sfida përfundimtare të pandemisë".

Forumi, me bazë në Gjenevë, ka shtyrë edhe më herët datat e

organizimit përkthjetë vit. "Ndonëse Forumi Ekonomik Botëror dhe Qeveria e Singaporit vazhdojnë t'i ndjekin rregullat përfundimtare të siguruar takime të sigurta dhe efektive, dhe shkalla e përhapjes së koronavirusit në Singapor vazhdon të jetë në

nivele të përballueshme, ndryshimet e kohës së takimit reflektojnë sfidat ndërkombëtare në luftim të pandemisë", është thënë në deklaratë.

Kufizimet globale në udhëtime e kanë bërë të vështirë planifikimin me prani fizike në

pjesën e parë të vitit, meqë rregullat e ndryshme të karantinës kanë shtuar kohën që duhet të kalohet përfundimtare, është thënë në deklaratë.

Ministria përfundimtare, Industri e Singaporit ka thënë se qeveria ka kuptuar sfidat me

të cilat përballet Forumi dhe është pajtuar përfundimtare.

Takimi vjetor i këtij Forumi zakonisht zhvillohet në muajin janar, në Davos të Zvicrës, mirëpo pandemia e ka bërë të pamundshme një gjë të tillë këtë vit.



OAK-u krijon Këshillin Profesional



Prishtinë, 4 shkurt (ER) - Krijimi i Këshillit Profesional, paraqitja e problemeve të ndryshme sektoriale me të cilat ballafaqohen bizneset, shpërfaqja e objektivave, planit

strategjik dhe prioriteteve të Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK), ishin pikat kyçë të cilat u trajtuan të enjten në tryezën e organizuar nga OAK.

Me këtë rast, kryetari i bordit i

OAK-së, Skënder Krasniqi, duke njoftuar të pranishmit përfundimtare e Odës së Afarizmit të Kosovës që ka bërë deri më tanë, ka thënë se ideja përfundimtare e Këshillit Profesional ka ardhur si rezultat i

konsultimeve paraprake me bizneset duke e parë të nevojshme dhe të rrugës krijuar e tij. Krasniqi ka theksuar se në kuadër të këtij Këshilli Profesional të OAK-së të gjithë përfaqësuesit e

bizneseve të cilët njëherësh janë edhe ekspertë të lëmit të tyre, do ta kenë mundësinë të jenë kontribut përfundimtare zyrtarë e çështjeve dhe problemeve që kanë të cilat kanë mbetur pezull.

Gjatë vitit 2020 janë raportuar vetëm dy raste më shumë të dhunës në familje në Gjilan

GJILAN, 4 SHKURT (ER) - Mekanizmi Koordinues Kundër Dhunës në Familje, i udhëhequr nga Zyrtarja për Barazi Gjinore, Lindita Salihu, ka mbajtur takimin e parë për vitin 2021, ku është informuar me punën dhe angazhimin njëvjeçar të institucioneve që trajtojnë rastet e dhunës në familje në Komunën e Gjilanit, duke e bërë njëherësh edhe krahasimin me vitin 2019.

Gjatë vitit 2020 janë raportuar vetëm dy raste më shumë të dhunës në familje në Gjilan. "Bashkëpunimi i mirë ndërinstitucional i të gjithë aktorëve që trajtojnë fenomenin e dhunës në

familje e bën pak më lehtë për të menaxhuar këtë problem, duke u dalë në mbrojtje viktimate të dhunës në familje. Sa i përket rehabilitimit dhe riintegrimit të tyre, ende mbetet sfidë që kërkon qasje më serioze shtetërore", ka thënë koordinatorja e Mekanizmit, Lindita Salihu.

Elmina Mahmuti, komandante rajonale e policisë në Gjilan, ka theksuar se, "pavarësisht pritshmërvive tona përritje të dhunës në familje nuk kushtet dhe rrëthanat e pandemisë, shkaku që ndikojnë shumë faktorë, si mbyllja, kufizimi i lëvizjes, humbja e vendeve të

punjës, karantinimi dhe masa të tjera, është shënuar një rritje e lehtë e raportimit të këtyre rasteve, në krahasim me vitin 2019". "Në Policinë e Kosovës janë raportuar vetëm dy raste më shumë, por brengosësë është fakti se rastet janë të përsëritura për të satën herë, andaj është i domosdoshëm trajtimi i recidivistëve në mënyrë që të ulet dhuna në familje", ka thënë Mahmuti. Mbrojtësi i viktimate, Gani Leci, në kuadër të zyrës për ndihmë viktimate, informoi pér shërbimet e ofruara profesionale deri në realizimin e plotë të të drejtave të qytetarëve, në 143 raste të



raportuara. "Periudha e pandemisë ka qenë mjaft sfiduese. Është dashur të punojmë me kujdestari 24 orë dhe rastet e dhunës në familje janë trajtuar me prioritet. Vlen tē theksohet se 42 kërkesa që janë drejtuar në gjykatë, si raste të rezikuara, të gjitha janë aprovuar nga gjykata e cila ka dhënë urdhër mbrojtës", ka thënë Leci.

Komuna e Mitrovicës nënshkruan marrëveshje përmbrrojtjen e të drejtave të grave



MITROVICË, 4 SHKURT (ER) - Nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, të enjten ka pritur në takim Ylberina Peci si dhe Dzeneta Celoviq nga OJQ "Mitrovica Women Association for Human Rights - MWAHR", me c'rast u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e të drejtave të njeriut, me theks të veçantë

përfshirjen e grave në proceset e vendimarrjes si dhe respektimin e përgjithshëm gjinor. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje OJQ "Mitrovica Women Association for Human Rights MWAHR" do të zhvillojë aktivitetë që do t'i forcojnë marrëdhëniet në mes të grave të etnive që jetojnë në regionin e

Mitrovicës dhe më gjerë, përfshirjen e tyre në proceset e vendimarrjes dhe respektimin e përgjithshëm gjinor. Me këtë rast, nënkryetari Mujka ka potencuar se Komuna e Mitrovicës me të gjitha mekanizmat e saj është duke punuar përmbrrojtjen e fuqizimin e femrave në shoqërinë tonë.

Policia sekuestron dy armë në Prishtinë

PRISHTINË, 4 SHKURT (ER) - Drejtoria Rajonale e Policisë në Prishtinë po ndërmerr të gjitha masat e nevojshme poliore përmbrrojtjen e siguruar rendin dhe qetësinë publike në rajonin e Prishtinës. Në kuadër të veprimeve operative që po kryen policia me qëllim parandalimin dhe zbulimin e veprave kriminale, tē enjten

në fshatin Barilevë, nga ana e zyrtarëve policorë janë gjetur dhe sekuestruar një revole (tipi zoraki) dhe një thikë. Personi i dyshuar është shoqëruar në stacion polior dhe ndaj tij, në konsultim me prokurorin e shtetit, është iniciuar rast përmbrrojtje në pronësi, kontroll ose posedim tē paautorizuar tē armës.



Rregullohet ura në Hajnoc të Kamenicës

KAMENICË, 4 SHKURT (ER) - Komuna e Kamenicës, përkatësisht Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient dhe Inspektorat, së bashku me kompani private si dhe "Krileva Company", kanë rregulluar një rrugë alternative pas rrënimit të urës në Hajnoc si pasojë e vërvimeve.

I pari i komunës, Qëndron Kastrati, ka thënë se nga sot qytetarët e dhjetë fshatrave tē bllokuara mund tē qarkullojnë

lirshëm përmbrrojtjen e urës. Kryetari Kastrati ka falenderuar tē gjithë për angazhimin dhe qytetarët përmbrrojtum. "Nga sot nxënësit e Shkollës Filllore 'Dëshmorët e Kombit' u janë rikthyer bankave shkollore, pas rregullimit të kësaj rrugë alternative tē rregulluar në bashkëpunim me kompanitë private përmbrrojtjen e urës. Tani qytetarët e

dhjetë fshatrave tē bllokuar pas rrënimit të urës në Hajnoc mund tē qarkullojnë lirshëm përmbrrojtjen e urës. Në Kamenicë, ndërkohë që jemi duke punuar tē bëjmë zgjidhje me Ministrinë e Infrastrukturës dhe FSK-në. Faleminderit kolegëve nga komuna që vazhdimisht janë në terren, kompanive private përmbrrojtjen e urës. Tani qytetarët e



Aziz Kelmendi dhe enigma e vrasjeve pa luftë në kohë robërie (19)

Aziz Kelmendi shpallet dëshmor i kombit dhe emërohen disa rrugë me emrin e tij




Lulzim SAHITI

së Paraqinit, më 3 shtator 2017, Shoqata e Dëshmorëve e Luftës së UÇK-së në Prishtinë i kishte dhënë Mirënjojhe familjes së Dëshmorit të Kombit Aziz Kelmendi.

Porosia e Aziz Kelmendit u cuar në vend

Në shenjë nderimi dhe kujtimi të qëndresës fisnike të dëshmorit Aziz Kelmendi, Kuvendi i Komunës së Shtimes, më 5. 4. 2013 ka pagëzuar një rrugë me emrin e tij. Një gjë të tillë e ka bërë edhe Komuna e Prishtinës, Prizrenit, Kamenicës, Lipjanit, Ferizajt etj. Ndërsa, më 2 shtator 2002 Unioni i Pavarur i Studentëve të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, me rastin e përkujtimit të përhershëm të studentit tonë të nderuar Aziz Kelmendi, në 15-vjetorin e rënies nga armata serbo-sllave, në shenjë respekti dhe nderimi dekoron me "Student Martir".

Ndërkaq, më 13 prill 2017, nr. prot. 0/2873, Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit apo të Internuarit të UÇK-së, pas tridhjetë viteve shpalli Dëshmor të Kombit Aziz Sadik Kelmendi. Certifikata e dëshmorit në fjalë është nënshkruar nga kryetari i Komisionit, gjenerallejtënant Agim Çeku, komandant i ShP të UÇK-së. Me rastin e 30-Vjetorit të ngjarjes




Aziz Kelmendi

Gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar për rastin "Paraqini" u tha se Aziz Kelmendi ishte për idenë që Kosova të fitojet statusin e Republikës, për realizimin e së cilës kishte potencuar se duhet të zhvillohet luftë e armatosur. Prandaj, për ta cuar amanetin e tij në vend, pas 12 vjetëve Besim Sadik Kelmendi (vëllai i Azizit) në vitin 1999 nga mërgimi iu bashku luftës së lavdishme të Ushtrisë

Kompanisë së Parë të UÇK-së në Mollopolc të Shtimes, në Batalionin e Parë të Brigadës 161 "Ahmet Kaçiku". Ndërsa nga viti 1998 në Zonën Operative të Llapit, pjesë e lavdishme e UÇK-së ishte bërrë edhe Pajazit Aliu, që dikur ishin së bashku në shërbim me Aziz Kelmendin në Paraqin. Falë luftës së lavdishme, më 12 qershor 1999 Kosova është çliruar përfundimisht nga Serbia dhe më 17 shkurt 2008 është bërrë shtet i

pavarur ashtu siç dëshironë edhe vet Aziz Kelmendi.

Gjatë kohës sa zhvillohej lufta në Kosovë, Rizah Xhakli ishte ende në vuajtje të dënimit në burgun e Pozharevcit, ndërsa Abdylxhemil Alimani e ka përjetuar masakrën e Dubravës më 19-24 maj 1999, ku ishte plagosur rëndë në një pusë, deri sa aty ishte strehuar së bashku me nëntë shokë tjerë. Mbi ta gjatë natës nga gardianët dhe paramilitarët serbë ishin hedhur bomba dore. Katër nga ata kishin




Besim Kelmendi, me arm° n° dor° n° vija t° fronti luft°s s° U'K-s°

shpëtar nga plagët, mirëpo pesë të tjerë, kishin mbetur të plagosur rëndë, njëri nga të cilët pas dy-tri dite kishte vdekur. Alimani kishte marrë shumë plagë në tërë trupin e tij, mirëpo ai kishte pasur një kurajë të pashoqe saqë as gjëmë nuk kishte lëshuar, tregojnë shokët e tij. Pas luftës së Kosovës, Alimani nga Burgu i Pozharevcit ishte ekstraduar në Burgun e Idrizovës në Maqedoni, ku nga atje ishte liruar definitivisht më 22 tetor 1999. Në biseda me shokët shqiptarë që shërbenin si ushtarë në Kazermën e Paraqinit, Azizi gjithmonë kishte

potencuar se shqiptarët në Jugosllavi nuk kanë të drejtë të barabarta, me theks të veçantë kishte thënë se shqiptarët në Maqedoni po jetojnë nën presion. Andaj, për t'i gjëzuar këto të drejtë të barabarta si gjithë popujt tjerë, në maj të vitit 2001 Abdylxhemil Alimani kishte cuar porosinë e Azizit në vend duke iu bashkuar radhëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Maqedoni, ku si rezultat i kësaj luftë çlirimtare, më 13 gusht 2001 është nënshkruar Marrëveshja e Ohër, përmes së cilës është konfirmuar se shqiptarët në Maqedoni janë etni shtetformuese. (Fund)




Afrim Mehmeti, komandant i Kompanisë s° Abdylxhemil Alimani gjat° shërbimit n° Rizah Xhakli gjat° vuajtjes s° d°nimit m° t° U'K-s° n° Mollopolc (ZON)



'lirimtare Kombëtare n° Maqedoni



KPD Zabela - Pozharevc



Prishtina fiton 'El Clasicon', kualifikohet në gjysmëfinale



SUHAREKË, 4 SHKURT - Në një ndeshje dramatike dhe interesante deri në fund, Sigal Prishtina ka mundur Pejën 88:90 (15:23, 24:15, 23:26, 26:26), duke kaluar në gjysmëfinale të Final 8 Kupës së Kosovës #VllesaPagesa. Ndeshjen më mirë e nisën bardhekaltrit, që kishin epërsi konstante në çerekun e parë dhe këtë pjesë e fitojnë 15:23. Prishtinasit vazhduan me lojë të mirë edhe në periodën e dytë, duke thelluar epërsinë në 12 pikë, 19:31, por me kalimin e minutave, këndellen pejanët duke hyrë në një seri shumë të suksesshme, ku arritën që pjesën e parë ta përfundojnë në të mirë të tyre 39:38. Në periodën e tretë u zhvillua lojë e barabartë, ku epërsia më e lartë ishte 41:47 dhe më pas asnjëra skuadër nuk arrinte të shkëputej në rezultat, derisa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 62:64. 10 minutat e fundit ishin shumë interesant dhe dramatik, pasi fituesi është vendosur në sekondat e fundit. Prishtina kishte epërsi 71:82, por Peja nuk dorëzohet sërisht, duke ngushtuar shifrat në 86:88, 13 sekonda para fundit, por prishtinasit arritën të menaxhojnë epërsinë dhe triumfuan 88:90, duke kaluar në gjysmëfinale, ku do të ndeshet me Ponte Prizrenin, takim që zhvillohet të premten nga ora 19:00. Te Peja u dalluan Dardan Berisha me 31 pikë, tetë kërcime dhe 12 asistime dhe Marko Peroviq me 25 pikë e nëntë

kërcime, kurse te Sigal Prishtina u dalluan Nigel Johnson me 33 pikë, shtatë kërcime e tetë asistime dhe Tevin Mack me 26 pikë, 12 kërcime e gjashtë asistime. Ponte Prizreni ka mundur Vëllaznimin 109:106 (29:31, 22:13, 23:28, 20:22, 15:12), duke u kualifikuar në gjysmëfinale të Final 8 Kupa e Kosovës #VllesaPagesa. Ndeshja e nisi e baraspeshuar, ku Vëllaznimi u treguar arrë e fortë dhe e fiton çerekun e parë 29:31. Por, prizrenasit ishin më të mirë në periudhën e dytë, duke e fituar 22:13, përmes pjesën e parë 51:44. Por, kuqezinjtë me kalimin e minutave fillojnë të afrohen në rezultat, ku shifrat në semafor pas 30 minutash ishin 74:72. 10 minutat e fundit ishin shumë interesante dhe dramatike. Ponte e filloj më mirë këtë pjesë, por kuqezinjtë sërisht rikthehen dhe barazojnë shifrat në 94:94 dhe fituesi është dashur të përcaktohet në kohën shtesë. Ponte ishte më e mirë në vazhdime, duke pasur epërsi në 107:100, ndërsa Vëllaznimi arriti të afrojë shifrat në 107:106, por pa arritur të bëjë më shumë dhe Ponte Prizreni triumfon 109:106. Te Ponte Prizreni u dalluan Arti Hajdari me 31 pikë, Jermaine Paige me 23 dhe Divine Myles me 20, kurse te Vëllaznimi u dalluan Andi Shehu me 31 pikë, Emmanuel Emogbo me 25 pikë e 16 kërcime dhe Cedric Council me 18 pikë e 13 kërcime. Ponte Prizreni në gjysmëfinale do të përballet me fituesin e ndeshjes

Peja-Sigal Prishtina, ndeshje që zhvillohet nga ora 19:00.

AS Prishtina kualifikohet në finale

Në një ndeshje shumë dramatike, AS Prishtina ka mundur Marigona Hill Prishtinën 72:73 (16:15, 26:25, 14:18, 15:14), në gjysmëfinale të Final 4 të Kupës së Ligës së Parë. AS Prishtina e nisi ndeshjen më mirë, duke pasur epërsi 3:9, por më pas zhvillohet lojë e barabartë dhe çereku i parë përfundon 16:15. Edhe perioda e dytë ishte mjaft e baraspeshuar, ku asnjëra skuadër nuk arrinte të kalonte në epërsi, kurse pjesa e parë përfundon 43:41. Në periodën e tretë, AS Prishtina ishte më e mirë, duke e fituar këtë pjesë 14:18, derisa rezultati në semafor pas 30 minutash ishte 57:59. 10 minutat e fundit ishin shumë interesante dhe dramatike, ku fituesi është vendosur në sekondat e fundit. Katër sekonda nga fundi, Sadiku i AS Prishtinës gjendet në vijën e gjuajtjeve të lira, ku shënon një herë dhe vendos fituesin përmes 72:73. AS Prishtina kaloi në finale dhe do të përballet me RC Cola Dritën, ku finalja do të zhvillohet të premten nga ora 13:00. Te Marigona Hill Prishtina u dallua Eliot Peci me 19 pikë e 10 kërcime, kurse te AS Prishtina, Dardan Sejdiu me 21 pikë e 12 kërcime dhe Alban Latifaj me 23 pikë e shtatë kërcime.

SHKURT

Kosova U16 grumbullohet të shtunën

Të shtunën do të bëhet grumbullimi i dytë radhazi i Kosovës U16 në konkurrencën e meshkujve. Fillimi është ishin mbi 50 lojtarë në grumbullimin e parë, listë që është reduktuar në 25. Basketbollistët e përzgjedhur do të grumbullohen të shtunën në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Për shkak të numrit të lartë, do të jenë dy stërvitje, ku lojtarët do të ndahen në dy grupe nga përzgjedhësi Dritëro Sefaja.

Kosova është organizatore e Kampionatit Evropian të Divizionit C përmes meshkuj U16, që do të mbahet gjatë kësaj vere në Prishtinë, pasi nuk ishte mbajtur përmes pandemisë me Covid-19. Kosova U16 (M) do të jetë në Grupin B me Shqipërinë, Armeninë, San Marinon, Gjibraltarin dhe Maltën.

Ballkani fiton miqësoren ndaj Malishevës

Skuadra e Superligës në futboll, Ballkani e ka mbyllur me fitore fazën e ndeshjeve miqësore, pasi e mposhti skuadrën e Ligës së Parë, Malishevë (3-2). Ermal Krasniqi, Meriton Korenica dhe Mirlind Daku shënuan golat e fitores përmes Ballkanit. Kurse, përmes Malishevës realizuan Albion Rahmani dhe Bleon Sekiraqa.

Shtyhet debutimi i Shkodran Mustafit

Shkodran Mustafi nuk do mund të debutojë me klubin e tij të ri, Schalke, as në këtë fundjavë. E gjitha kjo ka ndodhur përsye se rregullat në Gjermani parashohin që një lojtar i cili transferohet nga Anglia, të qëndrojë në karantinë. Kjo nënkupton se Mustafi mund të stërvitet i vetëm dhe të bëhet i gatshëm përmes ndeshjen e ardhshme, kur edhe mbaron karantina përmes tij. "Pas konsultimit me Departamentin e Shëndetësisë, Shkodran Mustafi do të jetë në karantinë të paktën deri më 5 shkurt. Lojtarë i transferuar nga Arsenal duhet të izolohet", thuhet në komunikatën e postuar nga klubin gjerman.

Hysaj: Do ta respektoj kontratën me Napolin

Elseid Hysaj ka thënë se nuk është koha të flasë përmes tij të ardhmen. E ardhmja e Hysajt është në ajër pasi kontrata i përfundon në fund të sezonit. Bisedimet përmes rinovimin kanë ngecur dhe të gjitha rrugët dërgojnë në ndarje në fund të sezonit. Sido që të jetë, si një profesionist i vërtetë, Hysaj thotë se nuk është koha përmes folur përmes njësive të tillë, por përmes tij të ardhmen e këtij sezonit. "Do ta respektojmë kontratën time, do të jap maksimumin përmes skuadrës deri në fund. Pastaj, kur të jetë momenti përmes folur, do të flasim. Jam këtu prej shumë vitesh, nuk mendoj përmes atë që do të vijë më pas. Jam shumë i përqendruar te skuadra", u shpreh Hysaj.

Paraqitet ekipi i Kosovës në 'eFootball'

Të enjten është bërë prezantimi i ekipoit që do ta përfaqësojë Kosovën në kualifikimet online të turneut UEFA eEURO 2021 në videolojën PES2021. Zgjedhja e dy lojtarëve që e përfaqësojnë Kosovën është bërë nëpërmjet turneut online, duke shfrytëzuar platformën e UEFA-s, e ku si lojtar të Përfaqësuesës së Kosovës janë përzgjedhur Genc Shala dhe Qlirim Isufi. Përveç fituesit e këtij turneu janë pritur nga presidenti Agim Ademi, e ku të pranishëm ishin edhe koordinatorët e projektit, Dardan Sadiku dhe Gent Gerdovci. "Kryetari Ademi përgëzoj dy të rintjtë që do ta përfaqësojnë Kosovën në 'eFootball', derisa u premtoi përkrahje në çdo aspekt, me qëllim të përfaqësimit sa më dinjitoz të përfaqësues sonë në këtë turne, ku gjithnjë e më shumë zgjon interesimin te të rintjtë. Gjithashtu, presidenti Ademi dy lojtarëve të ekipoit të Kosovës në kualifikimet përmes 'eEuro2021' u dhuroi nga një fanellë të kombëtares si dhe nga një top me logon e FFK-së", thuhet në njoftimin e FFK-së.

FShF-ja zbulon emrat e trajnerëve të ekipeve kombëtare të moshave

TIRANË, 4 SHKURT - Federata Shqiptare e Futbollit ka vendosur për emrat e trajnerëve të ekipeve kombëtare të moshave. Zyra e Shtypit në FShF bën me dije se Alban Bushi konfirmohet në këtë post dhe do të jetë sërisht trajner i ekipeve kombëtare U-21. Ndërsa

ekipin kombëtar U-20 do ta drejtojë tashmë trajneri i ri Ilias Haxhiraj. Trajneri i ri i ekipeve kombëtare U-19 është Armando Cungu, kurse ekipin e moshës U-18 do ta drejtojë Ardi Behari. Risia tjetër është emërimi i Ervin Bulkut si trajner i kombëtares U-17. Ish-

futbollisti i njohur ka qenë së fundmi edhe pjesë e stafit teknik të Kombëtares A dhe një nga ndihmësit e Edy Rejas. Gjithashtu, risi ka edhe për stolin e ekipeve të moshës U-16 që do të ketë si trajner Agron Kërçovën. Një tjetër konfirmim është ai i

Armand Damës, i cili do të vazhdojë jetë trajner i Kombëtares U-15. Trajnerët e ekipeve kombëtare ishin në skadencë kontrate dhe pas një procesi konsultimi Federata Shqiptare e Futbollit mori vendimin përfundimtar, duke konfirmuar dy prej tyre dhe



duke emëruar trajnerë të rinj në pesë ekipe të tjera.

Philadelphia mposhti Charloten, shkëlqen Antetokounmos

CHARLOTTE, 4 SHKURT - Philadelphia 76ers vijoi rrugën e fitoreve, duke konsoliduar akoma më tepër pozitat në Konferencën e Lindjes. Franchise nga Pennsylvania mundi 118-111 skuadrën e Charlotte Hornetsit brenda në Karolinën e Veriut, duke siguruar njëkohësisht edhe fitoren e katërt radhazi, ecuri që vazhdon t'i mbajë 76ers në vendin e parë në Lindje, me 16 fitore e vetëm 6 humbje. Në "Spectrum Center", në Charlotte, franchise në pronësi të basketbollistit legjendar Michael Jordan zbriti në parket pas tri fitoreve rresht dhe e nisi takimin menjëherë me një 4-0 të shpejtë. Miqtë realizuan pesë pikë radhazi për ta gjetur avantazhin e parë të ndeshjes, ndërsa skuadra e James Borregosit mori sërisht kryesimin në shifrat 7-5, me një sulm për tre. Ky ishte edhe rasti i fundit kur vendasit e panë veten në epërsi, sepse që nga ai moment basketbollistët e Philadelphias hynë në ritëm dhe udhëhoqën deri në fund takimin. Avantazhi më i madh i 76ers fluturoi deri në +26, në rezultatin 60-34, ndërsa në interval dy skuadrat shkuan me epërsinë e miqve me shifrat 64-42. Hornetsi u tregua i pafuqishëm dhe miqtë e kontrolluan më së miri ndeshjen, duke e mbajtur në distancë sigurie franchisen nga Karolina e Veriut. Në fund 76ers hoqi këmbën nga gazi dhe vendësít përfituan për ta ngushtuar diferençën. Gjithsesi ekipi i Philadelphias mbylli takimin me rezultatin 118-111, për ta regjistruar edhe fitoren e 14-t radhazi në përballjet



ndërmjet tyre, në një ndeshje ku spikati përsëri sulmuesi nga Kameruni Joel Embiid që e mbylli mbrëmjen me 34 pikë e 11 rebounde, në diçka më pak se 34-t që qëndroi gjithsej në parket. Nëse në klasifikimin e përgjithshëm të 15 skuadrave të Konferencës së Lindjes Phila kryeson me 3 fitore më shumë sesa Milwaukee Bucks, në Divizionin e Atlantikut 76ers kanë vetëm 2 fitore më tepër se Brooklyn Netsi i treshes Kevin Durant - Kyrie Irving - James Harden që, sidoqoftë, ka zhvilluar një ndeshje më shumë deri në këtë fazë të sezonit të rregullt. Ekipi i drejtuar nga kanadezi Steve Nash e kishte pushim, kështu që radhën për të luajtur e patën pikërisht basketbollistët e franchiset nga Wisconsin. Bucksi dominoi në takim, duke udhëhequr nga fillimi në fund ndaj Indiana Pacersit, që pësoi humbjen e tretë në katër ndeshjet e fundit. Në "Fiserv Forum", pranë fundit të periodës së tretë, basketbollistët e ekipeve të drejtuar nga trajneri Mike Budenholzer prekën përkohësisht edhe epërsinë e 36 pikëve, teksha kryesuan 106-70, gjithsesi në fund Milwaukee mbylli takimin me fitoren e thelli 130-110. MVP i dy sezoneve të fundit, Giannis

Antetokounmpo, e përfundoi takimin me triple - double, 21 pikë, 14 topa të rikuperuar dhe 10 asistime në vetëm gjysmë ore lojë, sidoqoftë në krahun tjetër 24-vjeçari nga Lituania, Domantas Sabonis, e mbylli sfidën me 33 pikë e 12 topa të rikuperuar për skuadrën nga Indianapolisi, që me këtë humbje mbetet në vendin e dytë në Divizionin Qendror në Lindje, me një fitore më pak dhe një ndeshje më shumë krahasuar me Milwaukee, raporton "Supersport". Vjuan formën e tyre të mirë edhe Los Angeles Clippersi, që regjistroi fitoren e 11-të në 13 sfidat e fundit, teksha mposhti 121-99 brenda në Ohio ekipin e Cleveland Cavaliersit. Në "Rocket Mortgage FieldHouse" vendësít u mbajtën vetëm për një pjesë loje, pasi në gjysmën e dytë të ndeshjes basketbollistët e franchiset kalifornianë u shkëputën ndjeshëm për të fituar krejt takimin me plot 22 pikë diferençë. Spikatën tek ekipi i drejtuar nga trajneri Tyronn Lue Paul George dhe Kawhi Leonard, që e mbyllën mbrëmjen respektivisht me nga 36 e 24 pikë secili, ndërsa te vendësít ra në sy Collin Sexton me 27 pikë. Me këtë triumf Clippersi mori kontrollin në Divizionin e Paqësorit me 17 fitore e 6 humbje, ndërsa Lakersi pozicionohet në vendin e dytë me bilancin 16 fitore e 6 humbje, ndërkohë në renditjen e përgjithshme të Konferencës së Perëndimit Utah Jazz vazhdojnë të kryesojnë, me 16 fitore e 5 humbje, për shkak të përqindjes më të lartë krahasuar me dy ekipe nga Los Anxhelos.

Ramosi gjithnjë e me afër Milanit

MILANO, 4 SHKURT - Milani ka nisur të mendojë seriozisht për kapitenin e Real Madridit, Sergio Ramos, i cili do të jetë lojtar i lirë në qershori, kur i skadon kontrata me Real Madridin. Kapiteni i skuadrës "merengues" nuk ka vendosur ende nëse do të vazhdojë me "Los Blancos" apo do të provojë një aventurë të re. Gazetari Paolo Condo, për kanalin "YouTube" të Stefano Borghiit, foli për situatën e mbrojtësit spanjoll, duke theksuar se 34-vjeçari do ta mendonte seriozisht transferimin te "Djalli". "Një mik



nga Madridi më zbuloi se ai nuk do të qëndrojë te Realit. Nëse Paolo Maldini do ta telefononte personalisht, ai do të mendonte seriozisht transferim në Milano. Do të ishte ndër i madh për Ramosin të luante për ekipin kuqezi. Të mos harrojmë se ishte Arrigo Sacchi ai që e afro

Ramosin në Madrid. Carles Puyol ishte i gatshëm të luante edhe falas vetëm për t'u bashkuar me Milanin. Kam kërkuar informacion nga drejtuesit e Milanit dhe kam mësuar se klubia ka bërë një sondazh, por pretendimet ekonomike të mbrojtësit nuk janë të arritshme. Mendoj se lojtari ka të ngjarë të shkojë te PSG-ja ose në Premierë Ligë", ka deklaruar Condo. 34-vjeçari është një nga lojtarët më të paguar në Spanjë dhe kuqezinjtë duhet t'i kushtojnë vëmendje buxhetit të tyre dhe "Fair Play Financiar".

SHKURT

Mulleri: Marr frymë vetëm për fitore dhe trofe

I fiksuar pas golave, asistimeve dhe sidomos fitoreve, Thomas Mulleri nuk ngopet kurrë dëshiron të vijojë të fitojë trofe me Bayern München. Sulmuesi i kampionëve të Gjermanisë dhe Evropës, në një rrëfim për "Kicker", flet hapur rrëth objektivave dhe ambicieve të tij. "Unë kam qenë i uritur për sukses gjatë gjithë jetës sime. Unë marr frymë për të fituar ndeshje dhe trofe. Jam gati të punoj fort çdo ditë për një gjë të tillë. Nuk dua të ndalem së fituari, por nuk duhet të harrojmë një gjë: në futboll nuk ia del kurrë të fitosh i vetëm, ke nevojë për ndihmën e gjithë skuadrës", ka deklaruar Mulleri.

Covid-19 prek edhe Dembele

Atletico Madridi humbet një tjetër lojtar të rëndësishëm. Pas portugezit Joao Felix, edhe sulmuesi i ri i madrileneve bardhëkuqe, Musa Dembele, është infektuar me Covid. Lajmi u konfirmua nga klubia në faqen zyrtare. "Futbollisti ynë Musa Dembele ka rezultuar pozitiv. Ai është izoluar në shtëpinë e tij duke respektuar rekomandimet e autoriteteve shëndetësore", ka njoftuar skuadra nga Madridi. 24-vjeçari është dhënë në formë huazimi nga Lyoni dhe në fund të edicionit do të bilihë nga Atletico. Ai ende nuk ka debutuar me ekipin e ri.

Asamoaha nënshkruan për Cagliarin

Pas largimit nga Interi verën e kaluar, Kwadwo Asamoah gjen skuadër të re. Ganezi është zyrtarisht lojtar i Cagliarit. Ardhja e 32-vjeçarit në skuadër i jep më shumë vlera dhe cilësi sulmit të skuadrës. Pas disa ditëve stërvitje me grupin, futbollisti duket se i ka bindur drejtuesit e klubit për t'iu bashkuar kështu skuadrës sarde. Asamoah do të jetë pjesë e skuadrës së drejtuar nga Eusebio Di Francesco deri në fund të sezonit.

Marseille e kërkon Favren

Marseille është në kërkim të një trajneri të ri pas dorëheqjes së Andre Villas-Boas. Në listën e klubit francez janë të shumtë emrat si Benitez, Mazarri, Valverde dhe Sarri, por më i preferuar i drejtuesve të këtij klubi është Lucien Favre. Ish-trajneri i Dortmundit është kontaktuar në orët e fundit nga klubli. Për teknikun zviceran do të ketë lajme të reja gjatë fundjavës ku skuadra marsejeze pritet t'i ketë të qarta kërkuesat e trajnerit të njohur.

'Marca': Alaba ka arritur marrëveshje me Realin

David Alaba, pas përfundimit të këtij edicioni, do ta vazhdojë karrierën në Spanjë. Gazeta spanjolle "Marca" ka raportuar të enjten, se Alaba këtë verë do të transferohet si futbollist i lirë te Real Madridi pasi kontrata me Bayern Münchenin i skadon në qershori. Madje thuhet se Alaba tashmë ka arritur marrëveshje me Realin, me të cilin ka firmosur parakontratë. Alaba është pajtuar me një marrëveshje katërvjeçare dhe pagë vjetore mbi 15 milionë euro te Realit. 28-vjeçari do të jetë përforcimi i parë i Realit për sezonin e ri. Ai te madrilenët shihet si lojtar i duhur, i cili pa problem mund të luajë në mesfushë dhe mbrojtje. Alaba prej viti 2011 është pjesë e Bayernit, kurse këtë edicion ka shënuar dy gola dhe ka bërë një asistim në 25 ndeshje përbazë.

Rallëherë ndodh qe lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtarie filmkëre sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymber Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisitorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthur me një egzegjiezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyjn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zërthen relationet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përqohet te ne nëpërmjet urdhreve biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesës dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të lehojë naa secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kießlowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të rinqallat metamorfoza progresive e mendies tonë...

Orhan Kerkezi


Kur shikohet "Dekalogu" i Kießlowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënja se 'thieshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

CIMINI: 5.99 €



A dramatic black and white photograph of four hands against a dark background. The hands are arranged in a cluster, with some fingers interlaced. A central black rectangular area contains the title text. The lighting is low-key, highlighting the skin texture of the hands.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskovo Pravde-Ministry of Justice

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanë Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 04.02.2021
 001/2021

Referenca: AAPSK -



AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:


Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestare/cop ë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Mercedes S400 CDI 220, viti i prodhimit 2001, dizel, ngjyre e zeze metalike, me targa vendore-Rishpallje	1 copë	2,775.00 €		
2	Opel Corsa ,viti i prodhimit 1994,benzin,ngjyre e hirit metalike, me targa vendore	1 copë	300.00 €		
3	BMW X5, ngjyre e hirit metalike-për skrap	1 copë për skrap	537.00 €		
4	Motoçikletë Harley Davidson V-Road, ngjyrë e hirit metalike, benzin- për skrap	1 copë- për skrap	540.00 €		
5	Mercedes Benz 201, ngjyre e zeze-për skrap	1 copë për skrap	296.00 €		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më 11.02.2021 në ora 11:00h, në lokatë e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-së) fshati Llukar KK Prishtinë. Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 11.02.2021, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë.

Pasurit e konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandidat-listën e artikujve në zyrën nr 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-së, një: <https://md.rks-gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.

Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, katër 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 18 051.

PËR SIGURINË E JUAJ DHE PUNONJËSVE TANË, JU LUSIM QË GJATË PJESËMARRJES NË ANKAND TË MBANI MASKËN KUNDËR COVID19; MBANI DISTANCËN DHE DEZINFEKTONI DUART RREGULLISHT!



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[facebook](http://www.facebook.com/gjejpunespejte)  www.facebook.com/gjejpunespejte

RESTAURANT



SWISS

TAVERNA



Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Aldina Bajra shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shfmu "Nefit Jusufi " Skorobisht.
- Halim Susuri shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhure.
- Menar Lezi shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Emin Duraku " Prizren.
- Sadije Halili shpall të humbur dëftesën e shkollës fillore "Naim Frashëri" Prishtinë.
- Fatos Luashtaku shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Skënderbeu".
- Esat Ferati B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb .71296555.
- Shaha Gerguri shpallë të pavlefshme diplomën e SHMLM " Dr. Xheladin Deda".
- Jap banesë me qira afér 60 m2, katër III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhamet Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, katër dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhamet Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përboll "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, katër dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Banesa lëshohet përfatë të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesë një dhomshe me qira , në lagjen Dardania afér Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme përfatë banim. Më shumë informata në: 044/706-079.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afér AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.
- Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, katër i l-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi përfatë person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L